



Republika e Kosovës

Komuna e Drenasit

Kuvendi i Komunës



Nr. 02-06061-4377 dt. 10/10/ 2024

PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. **20.09.2024**, ora **11:00**

Mbledhjen e kryesoi: Azemine Bujupi Gjoka anëtarja me e vjetër e KPF-së në mungesë të kryesuesit të Kuvendit Komunal, Kryesuesja e mbledhjes deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa ku të pranishëm ishin: Kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Hamit Kastrati (PDK), Malsore Cakiqi (PDK), Azemine Bujupi Gjoka (DD), Hamit Haxhiu (DD), Arbër Halilaj (GREEN), Florentina Elezi-Veliu (VV) si dhe Drejtor të Drejtorive Komunale.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend Dite:

1. Procesverbal i mbledhjes se KPF-se i dt.16.09.2024 ,për dëgjimin e përgjithshëm buxhetore ,për draft buxhetin e vitit 2025 dhe projeksionit për vitin 2026-2027.
2. Propozim vendim për Financimin e projektit “Handikos”
3. Propozim vendim për aprovimin e Planit të punës për Ekipin Komunal për të drejtat e Fëmijës, Drenas (2024-2027)
4. Te ndryshme.

Azemine Bujupi Gjoka, pasi përshëndeti të pranishmit, deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për Politikë dhe Financa, ku prezantoi rendin e ditës.

Arbër Halilaj, është ndoshta çështje teknike por pasi kam qenë prezentë në takimin, për dëgjimin e përgjithshëm buxhetore për buxhetin e vitit 2025 dhe projeksionit për vitin (2026-2027), po e shohë të faqja 3 pas diskutimit të Xhafer Doberdelanit për shkak të korrektësi të shtohet pjesa që është thënë aty është pjesa ku kryetari i Komunës Ramiz Lladrovci thotë që sot nuk jam për të marrë ankesa rreth projekteve të kaluara por për projektet e reja që mund të kemi kërkesa të reja .

Pasi që nuk pati diskutime hodhi në votim rendin e ditës, prezent gjatë votimit ishin 7 anëtar dhe votuan me: “Për” 7 vota , “kundër” nuk pati, “abstenim” nuk pati.

Azemine Bujupi Gjoka kryesuesja e mbledhjes hapi diskutimin pikën e dytë të rendit të ditës
2. Propozim vendim për Financimin e projektit “Handikos”

Hamit Kastrati, unë jam pro financimit të këtij projekti .

Arbër Halilaj, duke pas për bazë natyrën e punës së shoqatës Handikos si dhe përkushtimin e atij stafi në shërbim të personave me aftësi të kufizuara unë natyrisht që jam pro që kjo pikë të shkon në seancë edhe mundësisht të aprovohet kjo shumë e financimit.

Azmine Bujupi Gjoka, kryesuesja e mbledhjes hodhi në votim meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime hodhi në votim këtë pikë Propozim vendim për Financimin e projektit “Handikos” votuan : “Për” 7 vota “kundër” nuk pati “abstenim” nuk pati, e rekomanduan këtë pikë të rendit të ditës për kuvend.

Kryetari Ramiz Lladrovci për shkak të procedurës pika në komitetin për politikë e financa rekomandohen për kuvend nuk votohen.

Azmine Bujupi Gjoka kryesuesja e mbledhjes rekomandon për seancë në kuvend pikën 3. Propozim vendim për aprovimin e Planit të punës për Ekipin Komunal për të drejtat e Fëmijës, Drenas (2024-2027) meqë nuk pati diskutime vërejtje apo sugjerime edhe kjo pike rekomandohet për seancë .

Meqë nuk pati diskutime me 7 vota “Për” “kundër” nuk pati “abstenim” nuk pati e rekomanduan për kuvend këtë pikë e rendit të ditës.

Azmine Bujupi Gjoka kryesuesja hapi diskutimin për pikën e katërt e rendit të ditës 4. të ndryshme Azmine Bujupi Gjoka kryesuesja e mbledhjes pasi nuk pati diskutime të tjera e konsideroj të mbyllur mbledhjen, mbledhja përfundoj rreth orës 11:20 min .

Procesmbajtëse:



Fakete Hoti



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Azmine Bujupi Gjoka